



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0027

OSHP:2025/0031

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “EJONA” SH.P.K., si dhe OE “BUSINESS PRO” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të “Ngrohtorja e Qytetit Termokos” Sh.A., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me kembyes të nxehtësis 11 MW” me numër të prokurimit NP Termoskos.sha-24-8946-1-2-1, me 03/04/2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohen** si të bazuara ankesat e OE “EJONA” SH.P.K., me nr. 2025/0027, e datës 09/01/2025, si dhe OE “BUSINESS PRO” SH.P.K. me nr.2025/0031 e datës 10/01/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me kembyes të nxehtësis 11 MW” me numër të prokurimit NP Termoskos.sha-24-8946-1-2-1.
2. **Anullohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “Ngrohtorja e Qytetit Termokos” Sh.A., ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Furnizim me kembyes të nxehtësis 11 MW” me numër të prokurimit NP Termoskos.sha-24-8946-1-2-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues aprovohen të bazuar, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.08.2024, “Ngrohtorja e Qytetit Termokos” Sh.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me kembyes të nxehtësisë 11 MW” me numër të prokurimit NP Termoskos.sha-24-8946-1-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 50,000.00 €.

Me 18.12.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë për aktivitetin e prokurimit OE “ZILONIS Kosova:SonFlow Deutschland GmbH.”- Prishtinë.

Me 23.12.2024, OE “EJONA” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 23.12.2024 po ashtu edhe OE “BUSINESS PRO” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 31.12.2024, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 09.01.2025, OE “EJONA” SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0027/2025, ndërsa me datë 10.01.2025 OE “BUSINESS PRO” SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0031/2025.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0027/2025 dhe ankesa nr. 0031/2025 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “EJONA” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI 1): Pretendimet tona bazohen ne atë qe AK shpërblen me kontrate GOE ZILONIS Kosova: SonFlow Deutchalnd GMBH i cili ka kryer ndërhyrje dhe falsifikim në katalog,ku ka kopjuar kërkesën në specifikimet teknike të detyrueshme në DT dhe ka shtuar vulën e një prodhuesi tjetër. Kjo fillimisht argumentohet në vlerësimin e komisionit vlerësues të AK të datës 23.09.2024 :

Ku shihet që AK ka heshtur dhe nuk ka vepruar konform nenit 26.14 të LPP-së edhe pse ka verejtur dokumentet të rremë dhe falsifikuar.

Këtë qe prezentuam më lartë e dëshmojmë edhe në vazhdim ku në faqen 11,12 dhe 13 të katalogut të prezentuar në të cilin shihet qe është e kopjuar dhe nënshkruar

Në faqen ne fund shkruan :Sketches of the gearbox with tehnicah data tani ketu shihet qarte falsifikimi i dokumentit ku bazuar në te dhenat teknike të kembyesve te prezentohet Gearbox është e qartë se gjatë falsifikimit i ka mbetë ky shënim i cili zakonisht perdoret per valvola mbyllëse dhe ne asnje rast për kembyes. Në katalogun e prezentuar prej 53 fletëve OE i propozuar për kontratë prezenton katalogun për prodhuesin SonFlow dhe ne nderkohe në faqet 11,12 dhe 13 ndërhyhet dhe futet prodhuesi CETETHERM dhe pastaj vuloset me vulen e SonFlow e cila verehet e falsifikuar.

Këtu qartësohet se behet fjalë për dy prodhues të ndryshëm dhe OE i propozuar për kontratë përdorë vulën e SonFlow dhe vulosë të dhënat teknike të prodhuesit Cetetherm si në vazhdim:

Këtu shihet qarte se OE ka ndërhyrë ne katalog dhe ka fshire te dhënat e prodhuesit dhe te klientit.

Nga ku shihet dhe dëshmohet se kemi të bëjmë me dy prodhues të ndryshëm dhe OE i propozuar për kontratë ndërhyrë në katalog dhe falsifikon të njëjtin duke shkelur nenin 65 të LPP-së dhe deklaratën nën betim. Për këtë AK është ne dijeni fare mire, pasi qe AK është bazuar ne këmbyesin e prodhuesit CETETHERM, ndërsa OE falsifikon katalogun duke i futur shënimet e Cetetherm ne katalogun e SunFlow i cili është komplet tjetër prodhues.

VETEM ME NJE KERKIM TE THJESHTE NE GOOGLE DUKE SHENUAR EMRIN E MODELIT CT240-GP8 E KUPTOJME SE KY ESHTË PRODUKT I CETETHERM, NDERSA OE I SHPALLUR FITUES E PREANTON SI PRODUKT TE SUNFLOW DUKE FALSIFIKUAR KATALOGUN.

Pra ky OE duhet te futet ne liste te zeze dhe asesi te shpallet fitues nga AK.

Pretendimet tona bazohen ne ate qe AK shpërblen me kontrate GOE ZILONIS Kosova:SonFlow Deutchalnd GMBH i cili është i papërgjegjshëm teknikisht dhe për me tepër falsifikon dokumentacion duke shkelur rende LPP & rregulloren, perkatesisht Deklaraten Nen Betim,ankesa jonë është sqaruar në vazhdim:

Njesia kërkuese ju ka referuar një modeli te prodhuesit CETETHERM pastaj bazuar në këtë, komisioni vlersues ka dhenë vendimin e vet.

Në këtë rast zyrtari i cili ka udhëhequr lenden është dashtë të nderhyjë dhe ti sqaroje komisionit teknik qe në këtë rast vlenë ekuivalenca e produktit bazuar në nenin 5.5 të specifikimeve teknike. Arsyetimet e komisionit të vlersimit ipen si në vazhdim:

Edhe pse vlenë ekuivalenca e sipërpermendur në vazhdim ju deshmojmë që në rastin konkret dimensionet e këmbyesit janë komplet identike.

Njësia kërkuese ka kërku këmbyesin me këto dimensione:

Me datën 12.11.2024 z.Blerim Morina sqaron si në vazhdim ku deklaroi që për 1 mm nuk mund të montohet këmbyesi gjë të cilën e din edhe vetë që është e paqëndrueshme.

Në vertikale lëvizë dimensionin 1294 në 1295 mm i cili është i papërfillshëm prej 1mm derisa dimensionin horizontal i flnashave është i njëjti .Nga ku dëshmohet që këmbyesi është ai i kërkuar në DT. Për të gjitha këto që cekem ju sigurojmë që këmbyesi i ofertuar nga ana jonë do të montohet pa asnjë ndërhyrje në rrjetë (ky montim mund të bëhet edhe me asistimin tonë në rast nevojë) dhe çuditërisht komisioni i vlerësimit të AK qëllimisht favorizon një OE të papërgjegjshëm dhe në këtë rast mashtrues.

PRETENDIMI 2): OE BAK ING nuk kanë plotësuar as kërkesat në DT:

OE BAK ING nuk ka ofruar referencat e punëve të ngjashme pasi që referencat e dorëzuara nga ta nuk kanë të bëjnë fare me ngrohje mirëpo të gjitha janë të materialit elektrik.

Po ashtu, ky grup i operatorëve ekonomik ka dorëzuar vetëm një deklaratë të përbashkët dhe jo 3 deklaratat sic parashihet në Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik.

Poashtu, i njëjti OE nuk ka kundërshtuar eliminimin e tij pas vendimit të parë, andaj ky OE nuk mirret parasysh në rivlerësimin e dytë.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE “EJONA” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues Konsiderojmë se janë shkele këto nene të UDHËZUESIT Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK 5. Specifikimet Teknike 5.5 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, si rregull i përgjithshëm është i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët “ose e barasvlershme/ekuivalente”. 5.8 Një dallim i qartë në mes të kërkesave të obligueshme dhe funksioneve të dëshiruara duhet të bëhet nga AK. Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 65 DEKLARATA NEN BETIM. Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit. Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës Bazuar në krejt këto që thamë më lartë mendojmë se ky proces i prokurimit është përfunduar në kundërshtim me LPP-në, RRUOPP-në andaj kërkojmë nga AK që pas shqyrtimit të kërkesës tonë, ta aprovoj atë si të bazuar dhe të marrë: V E N D I M te APROVOHET e bazuar Ankesa e OE “EJONA

SHPK” lidhur me tenderin Furnizim me kembyes të nxehtësisë 11 MW ANULOHEM- Njoftimi mbi Vendimin e AK Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A.dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, specifikimet teknike të kërkuara, LPP-në, RRUOPP-në ,që realisht më pas do duhej që FITUES të shpallej OE “EJONA SHPK”.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për “EJONA” SH.P.K., Departamenti i prokurimit ka pranuar kerkese per nshqyrtim nga O.E EJONA SH.P.K me daten:23.12.2024 ,pas pranimi te kërkesës per nshqyrtim kemi pezullar aktivitetin e prokurimit me daten: 24.12.2024. Zyrtan i prokurimit i është drejtuar departamentit të njësisë së kërkesës përmes emaili lidhur me kërkesen për nshqyrtim , të pranuar pasi qe pretendimet ankimore kane te bjene me pjesen teknike te keti aktiviteti te prokurimit ,dhe me datën 30.12.2024 kemi pranuar përgjigje nga zyrtari pergjegjes ne departamentin e prodhimit/kogjenesmit ku konfirmohet përgjigjeja e marre ne kohev e vlersimit te pare si ne vijim:

Grupi i Operatoreve Ekonomik ka ofertuar se bashku me prodhuesin son flow dhe autoriteti kontraktues ne vlersim e par ka kërkuar sqarim shtese nga GOE dhe kane konfirmuar se i plotesojne gjitha kerkesat e autontetit kontraktues gjith ashtu departamenti i prokurimit i ka derguar kerkesat per rishqyrtim prane departamentit te njesis se kerkeses dhe jane konstatuar se GOE i rekomanduar per kontrate i plotesone kerkesat e Autontetit kontraktues , Departamenti i prokurimit nuk ka ne perberje eksperte te kesaj fushe , perkatese dhe Oferta e rekomanduar per kontrate eshte oferta me cmim me te lire te ofruar.

Nese nje pretenim i tille vertetohet nga organet kompetente se ka ndryshime te dokumenteve , autoriteti kontraktues do teveproje konforme nemt 99 pika 2.

Autoriteti kontraktues ka vepruar konofrme Nem 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Sqarime në aspektin teknik lidhur me specifikat teknike të ofruara në DT për OE, per projektin " Furnizim me kembyes të nxetesisë 11MW"

Në DT të Operatont Ekonomik “Ejona”, në katalogun dhe specifikat teknike të prezantuara në DT të ofruara nga OE dhe specifikimit teknik të këmbysve në DT, ka një devijim në gjatësinë në mes të akseve vertikale të këmbysit në një distancë 1mm.

Dua që të theksoj që distanca mes akseve të këmbysit të nxetesisë në DT duhet të jetë i njëjtë 100% % si në vizatimin e kembyesit të nxetesisë në DT, sepse çdo ndryshim i distancës mes akseve të këmbysit shkakton probleme në kyqjen e kembyesit në sistemin egzistues në stacionin Bregu i Diellit. Duke u bazuar ne keto specifika teknike, konstatohet që kembysi I nxetesisë nuk është konform specifikave teknike ne DT.

Oferta e O.E EJONA SH.P.K nuk eshte oferta me cmimin me te lire te ofruar ka nje difference prej 11,446.08 euro me oferten e rekomanduar Bashkangjitur gjem emailin e pranuar nga njesia e kerkeses dhe përgjigjejen e GOE te rekomanduar.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BUSINESS PRO” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Në përputhje me nenin 109 , pragra? 2 te LPP-se dhe ne perputhje me nenin 64, prara? 1 I Rregullores 001/2022 per prokurimit publik, kundër vendimit të AK-së për dhënien e kontratës, ne parashtrojmë këtë ankesë. Ne mbesim pas të gjitha pretendimeve tona të parashtruara në Kërkesën tonë për Rishqyrtim, se AK ka bërë shkelje të rënda të dispozitave të LPP-së dhe të legjislacionit sekondar.

Pretendimet tona janë të njëjta sikurse në kërkesën tonë për rishqyrtim, por në këtë ankesë ne do të plotësojmë pretendimet tona me informata shitesë, të cilat i kemi marrë nga përgjigja e AK-së në Kërkesën tonë për Rishqyrtim, si dhe informacionet e marra nga AK me datë 06.01.2025 në kuadër të kërkesës sonë për qasje në dokumentacion, për pjesën e dokumentacionit që nuk na është dhënë në qasjen e pare me date 18.12.2024. AK, konkretisht komisioni i rivlerësimit, aspak nuk është marrë me Kërkesën tonë për Rishqyrtim. Në vendimin/përgjigjen e tij për Kërkesën tonë për Rishqyrtim, vetëm ka konfirmuar edhe një herë shkeljet ligjore, pasi nuk është përgjigjur në mënyrë konkrete në pretendimet tona. Ka dhënë një përgjigje sipërfaqësore dhe nuk ka trajtuar faktet dhe argumentet që ne i kemi dërguar së bashku me Kërkesën për Rishqyrtim. Se si ka rrjedhur procesi i rivlerësimit të ofertave dhe shqyrtimit të Kërkesës sonë për Rishqyrtim, janë të paraqitura në vijim.

FAKTE DHE ARGUMENTE

Gjatë procedurës së këtij aktiviteti të prokurimit, nga data kur janë parashtruar dy kërkesat për rishqyrtim (OE Zilonis dhe OE Ejona SHPK më 05.11.2024), deri në marrjen e vendimit që GOE Zilonis & Son Flow të shpërblehen me kontratë, AK ka bërë një varg shkeljesh të dispozitave të LPP-së, dhe ato janë si më poshtë: Neni 1, 7, 10, 11, 59 i LPP-së, dhe Deklarata nën betim e GOE-së të shpërblyer me kontratë dhe anëtarëve të komisionit të rivlerësimit. Detajet se si ka rrjedhur procesi i vlerësimit dhe i rivlerësimit. Më datë 31.10.2024, AK ka publikuar njoftimin për dhënien e kontratës, me të cilin vendim ne jemi shpërblyer me kontratë. Me këtë vendim të datës 31.10.2024, GOE Zilonis & Son Flow është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ku sipas letrës standarde për eliminim, AK ka dhënë këtë arsyetim:

Kundër vendimit të AK për dhënie të kontratës, dy OE kanë parashtruar kërkesën për rishqyrtim dhe me datë 05.11.2024, AK, përmes plaformës të e-prokurimit, ka dërguar një njoftim se aktiviteti i prokurimi pezullohet. Njotimi i AK

Më datë 13.11.2024, AK dërgon njoftimin tjetër se AK e kthen lëndën në rivlerësim. Njoftimi i AK-së

Më datë 18.12.2024, AK dërgon njoftimin për vendimin, me të cilin vendim AK/komisioni i rivlerësimit hodhi poshtë vendimin e parë të vlerësimit dhe tani shpërblen me kontratë GOE Zilonis – Dega në Kosovë & SonFlow AS, të cilët paraprakisht ishin eliminuar për shkak të specifikimit teknik jo të plotë dhe kopjimit të specifikimit teknik nga dosja e tenderit. Po të njëjtën datë, ne bëjmë kërkesën për qasje në dokumentacion. Qasja na është mundësuar më datë 19.12.2024, në ora 10:00.

Kundër këtij vendimi të AK, ne më datë 23.12.2024, kemi parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim. Më datë 31.12.2024, nga AK kemi pranuar vendimin/përgjigjen për Kërkesën tonë për Rishqyrtim. Më datë 31.12.2024, pas marrjes së vendimit në Kërkesën për Rishqyrtim nga AK, ne edhe një herë kemi kërkuar qasje në dokumentacion, ku kemi kërkuar pjesën e dokumentacionit që nuk na ishte dhënë më datë 18.12.2024 (qasja e parë në dokumentacion).

Qasja na është mundësuar me date 06.01.2025. Pas marrjes dhe analizimit të dokumentacionit, ne edhe një herë kemi arritur në të njëjtin përfundim, sikurse kemi përshkruar në Kërkesën tonë për Rishqyrtim, se OE i rekomanduar për kontratë nuk I ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe kushtet e AK-së të parashtruara në dosjen e tenderit. Prandaj edhe një here ne po i përshkruajm pretendimet tona ne mënyrë më të detajur. Më datë 18.12.2024, AK dërgon njoftimin për vendimin, me të cilin vendim AK/komisioni i rivlerësimit hodhi poshtë vendimin e parë të vlerësimit dhe tani shpërblen me kontratë GOE Zilonis – Dega në Kosovë & SonFlow AS, të cilët paraprakisht ishin eliminuar për shkak të specifikimit teknik jo të plotë dhe kopjimit të specifikimit teknik nga dosja e tenderit.

Po të njëjtën datë, ne bëjmë kërkesën për qasje në dokumentacion. Qasja na është mundësuar më datë 19.12.2024, në ora 10:00.

Kundër këtij vendimi të AK, ne më datë 23.12.2024, kemi parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim. Më datë 31.12.2024, nga AK kemi pranuar vendimin/përgjigjen për Kërkesën tonë për Rishqyrtim. Më datë 31.12.2024, pas marrjes së vendimit në Kërkesën për Rishqyrtim nga AK, ne edhe një herë kemi kërkuar qasje në dokumentacion, ku kemi kërkuar pjesën e dokumentacionit që nuk na ishte dhënë më datë 18.12.2024 (qasja e parë në dokumentacion). Qasja na është mundësuar me date 06.01.2025. Pas marrjes dhe analizimit të dokumentacionit, ne edhe një herë kemi arritur në të njëjtin përfundim, sikurse kemi përshkruar në Kërkesën tonë për Rishqyrtim, se OE i rekomanduar për kontratë nuk I ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe kushtet e AK-së të parashtruara në dosjen e tenderit. Prandaj edhe një here ne po i përshkruajm pretendimet tona ne mënyrë më të detajur.

PRETENDIMI 1 - Specifikimi teknik i OE të rekomanduar për kontratë AK gjatë rivlerësimit të ofertave nuk e ka bërë vlerësimin në përputhje me nenet 1, 7 dhe 59 të LPP-së, dhe po ashtu vlerësimin e ka bërë në kundërshtim me kërkesat e veta në dosjen e tenderit (Aneksi 1). SEPSE:

Pas marrjes së dokumentacionit të kërkuar më datë 19.12.2024, ne menjëherë, në të njëjtën ditë, përmes distributorit të autorizuar të prodhuesit ALFA LAVAL, tek prodhuesi, kemi dërguar katalogun e GOE-së që është shpërblyer me kontratë. Në të njëjtën ditë, më 19.12.2024, në ora 16:09, ne kemi marrë përgjigjen nga prodhuesi në lidhje me katalogun e GOE-së të shpërblyer me kontratë. Përgjigja e prodhuesit Alfa Laval në lidhje me katalogun e GOE-së të shpërblyer me kontratë është: Shih përgjigjen e prodhuesit Alfa Laval, si dhe përkthimin e përgjigjes së prodhuesit.

Perkthimi I shkresë se prodhuesit Alfa Laval

E nderuara znj. Demaj,

Faleminderit për dokumentacionin e dërguar për këmbyesin e nxehtësisë SonFlow. Kemi disa dyshime serioze për atë që ofron SonFlow. Komentet: Faqja 11 në manualin e udhëzimeve të SonFlow është një kopje e specifikimeve teknike të detyrueshme. Faqja 12 në manualin e udhëzimeve të SonFlow është një kopje e vizatimit nga specifikimi teknik i detyrueshëm. Faqja 13 është thjesht një kopje nga specifikimi teknik i detyrueshëm. Specifikimi teknik i detyrueshëm - bashkangjitur. Ne po ruajmë dokumentacionin origjinal të CT240-GP8 në bazën tonë të instaluar. Ky këmbyes nxehtësie është prodhuar nga Cetetherm (Cetetherm u ble nga Alfa Laval). Për më tepër, deklarojmë sa vijon: Modeli CT240 nuk mund të dorëzohet si i tillë, pasi ky model nuk prodhohet më. Dokumentacioni origjinal i CT240-GP8 mund të dorëzohet nëse

është e nevojshme (besoj se Termokos e ka këtë dokumentacion gjithashtu). SonFlow (ose kompania që përfaqëson SonFlow) nuk ka prezantuar:

- Modelin që do të dorëzohet
- Specifikimet teknike të certifikuar AHRI (si është llogaritur këmbyesi i nxehtësisë)
- Vizatim modeli i certifikuar AHRI

Kur citohen këmbyes nxehtësie të certifikuar me AHRI, ka një procedurë shumë të rreptë se si duhet të duket dokumentacioni dhe si duhet të dorëzohet.

Përmbledhje

Me dokumentacionin e dorëzuar - "Manuali i Udhëzimeve SonFlow" përdoruesi përfundimtar nuk mund të dij se cili model i këmbyesit të nxehtësisë do të dorëzohet, sa pllaka do të ketë, sipërfaqen e këmbyesit të nxehtësisë, në cilat kushte do të punojë. Me dokumentacionin e bashkangjitur - Faqja 11 dhe 12 në "Manualin e Udhëzimeve SonFlow", ne besojmë se është abuzim me pronën intelektuale të Alfa Laval dhe Alfa Laval do të mendojë për hapa të mëtejshëm ligjorë. Është jo-profesionale të vendoset vula e SonFlow mbi specifikimin e pllakatave dhe vizatimin që është dukshëm pronë e Alfa Laval.

Trzin, 19.12.2024: Shkresa e prodhuesit konfirmon vendimin e komisionit të vlerësimit, i cili kishte eliminuar këtë OE-në për shkak të specifikimit teknik jo të plotë dhe për arsye se si pjesë të katalogut të tij ka kopjuar dhe ka përfshirë specifikimin teknik, i cili ka qenë pjesë e dosjes së tenderit (këtë e kemi vërejtur edhe ne, mirëpo për të qenë më të sigurt, kemi kërkuar mendimin profesional nga prodhuesi).

Shkresa e prodhuesit konfirmon se si është abuzuar dhe keqpërdorur specifikimi teknik i dosjes së tenderit dhe se si OE i shpërblyer me kontratë ka ofruar të dhëna teknike të një këmbyesit të nxehtësisë i cili nuk prodhohet më DHE NUK ËSHTË PRONE E TIJ.

LETRA/SHKRESA E PRODHUESIT ËSHTË DËSHMI/FAKT I MAJTUESHËM QË DËSHMON SE KY OE KA OFRUAR INFORMATA TË RREJSHME DHE PERMBAJTËSISHT MASHTRUESE DUKE MANIPULUAR ME SPECIFIKIMIN TEKNIK TE DOSJES SE TENDERIT DHE DUKE E PERSHSHIRE KETE SPECIFIKIM TEKNIK SI SPECIFIKIM TE VETIN, SPECIFIKIM QE NE REALITET ËSHTË SPECIFIKIMI TEKNIK I PRODUKTIT QE ËSHTË PRONE INTELEKTUALE E PRODHUESIT ALFA LAVAL.

Mirëpo, për AK, ky fakt/dëshmi nuk është marr fare parasysh, thjesht është injoruar, edhe pse shkresa është mjaftë e qartë ashtu sikurse edhe vendimi i komisionit të vlerësimit i datës 31.10.2024 kur komisioni ka konstatuar se specifikimi teknik në katalogun e këtij OE është kopjuar nga dosja e tender. Para datës kur është marrë vendimi i datës 31.10.2024, AK/komisioni i vlerësimit të ofertave, lidhur me specifikimin teknik të ofruar, ka dërguar një pyetje për sqarim të tenderit tek GOE Zilonis&SonFlow.

Më datë 25.10.2024, OE i është përgjigjur AK-së. Gjatë qasjes në dokumentacion më datë 19.12.2024, kjo pyetje e AK-së, dërguar OE si dhe përgjigja e OEsë nuk na ishte dhënë. Kjo Pyetje e AK dhe përgjigja e OE na është dhënë vetëm me kërkesën tonë të dytë për qasje në dokumentacion me datë 06.01.2025.

Se ka pasur pyetje nga AK dhe përgjigje nga ky OE, ne e kemi vërejtur në kërkesën për rishqyrtim të OE-së Zilonis dhe, në bazë të kërkesës së tij për rishqyrtim, kemi arritur në përfundimin se tek ky OE, para marrjes së vendimit është dërguar një pyetje për sqarim të tenderit të tij e po ashtu kemi kuptuar se ky OE ka dërguar një përgjigje, por data kur është dërguar pyetja nga AK dhe data kur është përgjigjur OE, këtë nuk e kemi kuptuar para parashtrimit të kërkesës tone për rishqyrtim.

Për më tepër, nëse analizohet kërkesa për rishqyrtim e GOE-së, i cili është shpërblyer me kontratë, në asnjë pjesë të kësaj kërkesë, OE nuk e ka arsyetuar dhe as dëshmuar se specifikimi teknik të cilin e ka ofruar ai në dosjen e tij të tenderit nuk është kopjuar nga dosja e tenderit dhe po ashtu nuk ka dëshmuar se specifikimi është në përputhje me kërkesat e AK-së, të përshkruara në Aneksin 1 – specifikimet teknike të detyrueshme. Në tërë kërkesën e tij për rishqyrtim, ky OE vetëm ka kundërshtuar AK-në për eliminimin dhe ka pohuar se specifikimi teknik i ofruar nga ai është në përputhje me specifikimin teknik të kërkuar në dokumentacionin e tenderit, por nuk ka ofruar asnjë argument apo fakt që do të dëshmonte se specifikimi i tij teknik nuk është kopjuar nga specifikimi teknik i dosjes së tenderit të AK-së. Nuk ka dhënë asnjë dëshmi që të kundërshtojë vendimin e AK-së për eliminim. Pas marrjes së pyetjes nga AK dhe përgjigjes së OE në pyetjen e AK me datë 06.01.2025, vërehet se në përgjigjen që ky OE e ka dërguar më datë 25.10.2024, nuk është dhënë ndonjë argument apo fakt që të dëshmojë se specifikimi i tij teknik i plotëson kërkesat sipas dosjes së tenderit. Përkundrazi, edhe në përgjigjen që ka dhënë ai, për pjesën që ka kopjuar nga dosja e tenderit, konfirmon se ajo është pjesë e katalogut të tij dhe, në realitet, ky ka kopjuar specifikimin teknik të dosjes së tenderit.

Nga sa shihet në përgjigjen e këtij OE, ky OE ka ofruar këmbyesin tipin/modelin SF152, ndërsa në pjesën tjetër të sqarimit të tij ka ofruar tipin/modelin e këmbyesit CT 240-GP8, ku e ka rrumbullaksuar tipin e këmbyesit (tipin e këmbyesit që e ka kopjuar nga dosja e tenderit dhe që nuk prodhohet më).

Me këtë përgjigje ky OE bien ë kundërshtim me vetveten, sepse në njerën anë konfirmon se ka ofruar tipin/modelin e këmbyesit SF 152 e në anën tjetër konfirmon se ka ofruar tipin apo modelin CT240-GP8 me specifikimet teknike të dhëna në dosjen e tenderit. Shih specifikimin teknik në përgjigjen e këtij OE, ku ky OE e ka rrumbullaksuar modelin e këmbyesit të cilin e ofron e që në realitet ky model është dhënë në dosjen e tenderit dhe është model i cili nuk prodhohet më.

E kjo është dëshmi mjaft e qartë dhe tregon se ky OE specifikimin teknik e ka kopjuar nga dosja e tenderit dhe e ka paraqitur si pjesë të specifikimit/katalogut të tij.

Prandaj, është shumë befasisëse dhe, në të njëjtën kohë, shqetësuese se si njësi kërkuese, pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të këtij OE, është konstatuar se ky OE 100% i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Sipas kësaj përgjigje, komisioni i rivlerësimit ka marrë vendimin, me të cilin vendim e ka shpërblyer me kontratë një OE që as për së afërmi nuk i ka plotësuar kërkesat e AK-së të përshkruara në dosjen e tenderit e për më tepër ka kopjuar dhe ka manipuluar dhe falsifikuar specifikimin teknik të dosjes së tenderit. Komisioni i parë i vlerësimit e ka vërejtur këtë manipulim, dhe ka dhënë vendimin e vet, në cilin vendim ka konstatuar se ky OE nuk i ka plotësuar kërkesat për specifikim teknik, dhe po ashtu ka kopjuar specifikimin Teknik nga dosja e tenderit dhe e ka paraqitur këtë specifikim si pjesë të katalogut të vet (kjo dëshmon se komisioni i vlerësimit e ka vërejtur se ky OE ka falsifikuar specifikimin Teknik). MIRËPO, është edhe një fakt tjetër shumë i rëndësishëm të ceket se: KY OE jo vetëm që nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit për specifikim teknik, dhe përveç se e ka kopjuar specifikimin teknik

të dosjes së tenderit, ku ka përfshirë specifkimin teknik të dosjes së tenderit si pjesë të katalogut të tij, ky OE ka abuzuar dhe ka falsifikuar edhe specifkimin e tij teknik. Kur e themi këtë, e kemi parasysh faktin se specifkimet teknike të dorëzuara nga OE-ja nuk janë të njëjta me dimensionet, sikurse specifkimet teknike që ky prodhues ka në faqen e tij të internetit.

Nëse shikoni faqen e internetit të prodhuesit SonFlow në linkun "Downloads", menjëherë do të shihni të gjithë dokumentacionin teknik dhe manualët/udhëzimet për të gjitha produktet e SonFlow. Kur të shkarkoni manualin dhe udhëzimet e këtij prodhuesi lidhur me të gjitha llojet e këmbyesve të nxehtësisë, në asnjë prej këtyre udhëzimeve dhe specifikimeve teknike nuk mund të gjeni specifikimet teknike që ky OE i ka ofruar në katalogun e tij në faqen 11, 12 dhe 13. Kjo nënkupton se ky OE e ka kopjuar specifikimin teknik të dosjes së tenderit dhe, me këtë, ka falsifikuar katalogun e tij dhe ka dhënë informata mashtruese. Kjo vërehet edhe në dimensionet e këmbyesit të nxehtësisë. Në katalogun e paraqitur në dosjen e tij të tenderit, ky OE ka paraqitur dy specifikime teknike për këmbyesin e nxehtësisë të tipit/modelit:

Tek të dy tipet e këmbyesve të nxehtësisë dimensionet e këmbyesit janë të njëjta, mirepo nëse e shikoni në web faqen e këtij prodhuesi, dimensionet e këtyre këmbyesve dallojnë dhe nuk ajne të njëjta me dimensionet e ofruara në dosjen e tenderit. Në web-faqen e prodhuesit, dimensionet e këtyre këmbyesve dallojnë dhe nuk janë të njëjta me ato që janë paraqitur në dosjen e tenderit. Ju lutem shikoni vizatimin që është paraqitur në dosjen e tenderit, në faqet 6 dhe 8 të katalogut të këtij OE, dhe pastaj krahasoni me vizatimin e këtyre këmbyesve që mund të gjenden në web-faqen e prodhuesit SonFlow. Ky krahasim do të vërtetojë dallimet mes dimensioneve të ofruara nga ky OE dhe specifikimeve të kërkuara në dosjen e tenderit.

Vizatimet e prezentuara në dosjen e tenderit në katalogun e GOE për tipin/modelin AF152, AF154 & AF156 DHE SF151, SF151D, SF152, SF154 & SF156 (faqe 6 dhe 8 në katalogun e këtij OE). SHIKONI VIZATIMIN NË WEB FAQEN E PRODHUESIT. Shikoni se si dimensionet e këmbyesve të nxehtësisë që ka ofruar ky OE në ofertën e vet, ndryshojnë nga katalogu origjinal që gjendet në web-faqen e prodhuesit SonFlow. Dimensionet që kanë ndryshuar janë të rrethuar me vijë të kuqe. Dimensionet e ndryshuara nga katalogu origjinal janë si më poshtë:

- Në katalogun e OE-së, i paraqitur në dosjen e tenderit, distanca në mes të akseve S1-S2 është dhënë dimensionin prej 1294 mm, ndërkohë që në katalogun origjinal të web-faqes së prodhuesit, ky dimension është 1292 mm.
- Dimensionin tjetër, distanca në mes të akseve S4-S1 në katalogun e këtij OE në ofertë e tij është 298 mm, ndërsa në katalogun origjinal në web-faqen e prodhuesit është 296 mm.

Nëse e marrim parasysh përgjigjen nga njësia kërkuese të datës 22.10.2024 në lidhje me dimensionet, shihet se ky OE nuk i ka dimensionet e këmbyesit sipas kërkesës së AK-s, por i ka ndryshuar /falsifikuar dimensionet në mënyrë që ti pershtatet kërkesave të dosjes së tenderit. Shih përgjigjen e njësise kërkuese.

Për më tepër, në web-faqen e prodhuesit SonFlow, katalogu për tipin e këmbyesve AF152, AF154 & AF156 nuk ekziston fare. Ky katalog është marrë nga web-faqja zyrtare e Zilonis Gjermani (download center). Shikoni web-faqen e Zilonis Gjermani dhe web-faqen e prodhuesit SonFlow për të krahasuar informacionin dhe dimensionet.
?le:///C:/Users/User/Downloads/datasheet_af150-series_uk_0623-1%20(3).pdf

Ky produkt ekziston vetëm në faqen e prodhuesit Zilonis Gjermani, por nuk gjendet tek prodhuesi SonFlow. Po ashtu, produkti për të cilin OE thotë se ka ofruar SF151 është i pranishëm si në web-faqen e Zilonis Gjermani, ashtu edhe në web-faqen e prodhuesit SonFlow. Shikoni në web-faqet e të dy prodhuesve për të verifikuar këtë informacion.

[?le:///C:/Users/User/Downloads/datasheet_sf150-series_uk_0623-1%20\(2\).pdf](https://sonflow.eu/media/awlp/sglsv/datasheet_sf150-series_uk_0623-1%20(2).pdf)
https://sonflow.eu/media/awlp/sglsv/datasheet_sf150-series_uk_0623.pdf Prandaj, shtrohet pyetja: 1. Ku i ka parë njësia kërkuuese specifikimet që OE i ka ofruar dhe ku janë ato në përputhje me kërkesat në dosjen e tenderit?

Ky është një pyetje kyçe, pasi kërkesa e tenderit për një produkt të caktuar është e qartë dhe specifike. Nëse OE ka ofruar një produkt që nuk ka dimensionet e kërkuara, siç është kërkuar në DT, (gjatësia, gjerësia, distanca në mes të vrimave, distanca e mbështetjes, etj.), si mund të konstatohet se ky produkt është në përputhje me kërkesat e tenderit? Njësia kërkuuese duhet të jetë në gjendje të japë një shpjegim të saktë dhe të besueshëm mbi këtë çështje. 2. Dimensionet që nuk përputhen me kërkesat e tenderit:

Dallimi i dimensioneve të rëndësishme, siç janë dimensionet mes akseve të vrimave dhe gjerësia e këmbyesit, është një shkelje e qartë e kërkesave të tenderit. Kjo krijon një problem të mundshëm gjatë instalimit të pajisjes, pasi çdo devijim nga dimensionet e kërkuara mund të sjellë pasoja të konsiderueshme. o Për shembull, gjerësia e këmbyesit e kërkuar është 650 mm, ndërsa OE ka ofruar 502 mm, që është një ndryshim i konsiderueshëm prej 148 mm. o Gjatesia e këmbyesit e kërkuar është 1885 mm, ndërsa në katalogun e OE nuk jepet asnjë informacion në lidhje me këtë dimension. o Po ashtu, distanca e mbështetjes prej 275 mm, e kërkuar nga AK, nuk është përfshirë fare në ofertën e OE, duke e bërë ofertën e tij të paplotë dhe të pasaktë.

Çdo devijim nga specifikimet e kërkuara ka mundësinë të krijojë vështirësi të mëdha gjatë montimit dhe përdorimit të këmbyesit të nxehtësisë. Kjo mund të çojë në vonesa, rritje të kostove dhe mundësi të humbjes së funksionalitetit të pajisjes. Po ashtu, kjo nënkupton se oferta e OE-së është e pamjaftueshme dhe e pasaktë për të përmbushur kërkesat e tenderit. Në këtë kuadër, është e domosdoshme që njësia kërkuuese të përqendrohet në shqyrtimin e këtyre mangësive dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar që vetëm ofertat që plotësojnë kërkesat e tenderit të pranohen. Po ashtu, është thelbësore që çdo ofertë që nuk është në përputhje me specifikimet të eliminohet, për të ruajtur integritetin e procesit të tenderimit dhe për të shmangur çdo lloj manipulimi ose falsifikimi.

PRETENDIMI 2-Certifikata CE e kërkuar në dosjen e tenderit Në dosjen e tenderit në kuadër të kërkesave për aftësi teknike dhe ose profesionale, përveç tjerash është kërkuar edhe: Kërkesa në kuadër të pikës 9.1 dhe 9.2 të FDT-së 3. O.E. për produktin e ofruar duhet të posedojë Certifikatën Evropiane CE. GOE në dosjen e vet të tenderit, në ofertën e vet, Deklaratën CE që e ka prezantuar nuk është për tipin/modelin e këmbyesve që janë kërkuar. Deklarata CE është për tipin e këmbyesve Brazeed Plate Heat Exchanger apo në gjuhën shqipe Këmbyes nxehtësie me plaka të salduara Shih foton e marrun nga katalogu i GOE

Shih certifikatën CE të cilën OE e ka ofruar me dosjen e tenderit, ku shihet se certifikata e ofruar nuk është për këmbyesin SF 152 të cilin OE e ka ofruar (sipas përgjigjes së këtij OE me datë 25.10.2024). Certifikata CE është për këmbyesin Brazeed Plate Heat Exchanger për modelet: Certifikata CE është ofruar nga OE për këtë tip të këmbyesve.

Shih Certifikatën CE të cilën OE e ka ofruar me dosjen e vet të tenderit.

Ndersa OE, sipas deklaratës së tij në përgjigjen e dhënë tek AK me datë 25.10.2024, ka deklaruar se ka ofruar këmbyesin të modelit Plate Heat Exchanger të modelit SF 152." Kjo Certifikatë NUK ËSHTË PER TIPIN E KËMBYESIT QË ËSHTË KËRKUAR NË DOSJE TË TENDERIT DHE PO ASHTU NUK ËSHTË CERTIFIKATË PËR KËMBYESIN TË CILIN OE E KA OFRUAR (SIPAS DEKLARATËS TË OE QË E KA DHËNË NË PËRGJIGJEN E VET ME DATË 25.10.2024) Shih foton e këmbyesit të cilin OE e ka ofruar sipas përgjigjes së OE në pyetjen e AK për sqarim të tenderit të tij

Në bazë të këtij fakti, këtij OE i mungon certifikata CE, dhe përveç që specifikimi teknik i ofruar nuk është në përputhje me specifikimin teknik të kërkuar dhe i mungojnë të dhënat e plota për këmbyesin e ofruar, Certifikata CE nuk është në përputhje me kërkesën e AK për certifikatë. Për sa i përket pretendimit tonë për certifikatën CE të cilën ky OE e ka ofruar, AK nuk është përgjigjur fare. Mos përgjigja ne konsiderojmë se paraqet aprovim të pretendimit tonë. **PRETENDIMI 3 – Referenca** Për sa i përket referencës së paraqitur nga ky OE, shihet se referenca është lëshuar nga kompania XELSION Heat Transfer Solutions.

Nëse e shikoni web faqen e Zilonis në Gjermani, do të shihni se ky prodhues, XELSION Heat Transfer Solutions, është pjesë e grupit të kësaj kompanie dhe është i paraqitur si prodhues i këmbyesve të nxehtësisë, prandaj edhe pyetja është: çfarë efekti ka blerja e këmbyesve të nxehtësisë, kur XELSION Heat Transfer Solutions është prodhues i këmbyesve të njëjtë. Prandaj, ne konsiderojmë se edhe referenca është e dyshimtë. Edhe për referencën, AK nuk është përgjigjur fare në këtë pretendim tonë. Andaj, konsiderojmë se pretendimi ynë qëndron. **Pretendimi 4 – Ky pretendim në të vërtetë nuk është pretendim, por thjesht një kundërshtim** ndaj konstatimit të AK-së se OE ka ofruar çmimin më të ulët se ne për 20,971.60. Kjo nuk do të thotë që, kur ofrohet çmimi më i ulët, të shpërblehet OE, i cili as për së afërmi nuk i ka plotësuar kushtet dhe kërkesat e AK-së të parashtruara në dosjen e tenderit. Nëse e shikojmë Udhëzuesin 001/2023 për Prokurimin Publik, shohim se ky OE jo vetëm që nuk i ka plotësuar kushtet dhe kërkesat e AK-së dhe ka paraqitur informata përmbajtësisht të gabueshme dhe mashtruese, por edhe çmimi që ka ofruar ai është çmim abnormalë të ulët. Për këtë çështje, AK as që është munduar të kërkojë sqarime shtesë se si është e mundur që ky OE të ofrojë një çmim kaq të ulët, kur produkti i ofruar nga ai, kinse është me origjinë nga Danimarka (selia e prodhuesit Son Flow), ku dihet se Danimarka është një prej shteteve më të shtrenjta në Evropë. Edhe po të ishte oferta nga Kina, marrë parasysh shpenzimet e transportit, nuk do të mund të ofrohej një çmim kaq i ulët. Këtë çështje nuk e kemi përmendur në kërkesën tonë për rishqyrtim, sepse kemi menduar që AK do të përkushtohet në analizimin e fakteve dhe dëshmimeve të cilat ne i kemi dërguar, me të cilat kemi vërtetuar se OE i shpërblyer me kontratë ka ofruar informata të gabueshme dhe mashtruese, dhe kemi menduar se AK do të ndërmarrë masa ndaj këtij OE. AK jo vetëm që nuk ka marrë masa ndaj këtij OE, por përkundrazi, nuk i ka marrë parasysh faktet dhe dëshmitë që ne i kemi dërguar, i ka injoruar ato në tërësi me një arsyetim të pabazuar dhe AK e ka shpërblyer me kontratë këtë OE. Prandaj, si fakt shtesë në këtë ankesë, ne po e paraqesim edhe çmimin abnormalë të ulët që ky OE ka ofruar. Ky pretendim ka të bëjë me ofertën e OE-së që është rekomanduar për kontratë. Në bazë të Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, nenit 11, Tenderët Jo-normalisht të Ulët, ky OE ka paraqitur ofertë jo normalisht të ulët dhe AK është dashur të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së apo neni 41 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik.

Mirëpo, sido që të jetë, me rëndësi janë faktet si:

Manipulimi dhe falsifikimi i specifikimeve teknike dhe katalogut .

- Kopjimi i specifikimit teknik të dosjes së tenderit: OE ka kopjuar specifikimin teknik nga dosja e tenderit dhe e ka paraqitur si specifikim të vetin. Ky është një manipulim i qartë dhe një shkelje e dispozitave të LPP-se dhe Rregullores për prokurim publik.
- Falsifikimi i katalogut të OE: OE ka ndryshuar dimensionet e këmbyesit nga ato të paraqitura në katalogun origjinal që ndodhet në webfaqen e tij. Kjo tregon një ndryshim të mundshëm që është bërë me qëllim për t'i përshtatur dimensionet me kërkesat e tenderit, duke i dhënë kështu një pamje të rrejshme se ky këmbyes i ofruar është në përputhje me kërkesat.
- Shkelja e dimensioneve të kërkuara dhe mundësitë për probleme në montim

- Dallimi në dimensione: Dimensionet që janë ofruar nga OE janë të ndryshme nga ato që kërkohen në dosjen e tenderit. Dallimet, si p.sh. gjerësia e këmbyesit (502 mm kundrejt 650 mm të kërkuara) dhe dimensionet e tjera të ndryshuara (nga 1292 në 1294mm dhe nga 296 në 298 mm), paraqesin probleme serioze gjatë montimit të këmbyesit dhe mund të çojnë në ndërlikime për instalimin e tij.

- Pasojat e devijimeve të dimensioneve: Kjo është një çështje shumë e rëndësishme, pasi këto diferenca mund të ndikojnë direkt në funksionalitetin dhe sigurinë e instalimit të pajisjes. Çdo devijim i dimensioneve, përfshirë edhe distancat mes aksëve të vrimave, mund të shkaktojë probleme që janë të vështira për t'u korrigjuar pas vendosjes së pajisjes në vend.

- Manipulimi me informacionet e tenderit: Në kërkesën tonë për rishqyrtim, kemi paraqitur prova të mjaftueshme që vërtetojnë se OE ka manipuluar me specifikimin teknik dhe ka paraqitur informata të rrejshme dhe mashtruese. Kjo është një shkelje serioze e Deklaratës nën Betim nga ana e OE, dhe AK nuk ka ndermarre asnjë masë për këtë OE.

- Gjithashtu, ka një mungesë të informacionit të saktë për produktin, si dimensionet e sakta të këmbyesit, numri i pllakave, kushtet e operimit etj. Kjo paraqet një mangësi të rëndësishme në ofertë.

- Pasiviteti i AK dhe komisionit të rivlerësimit: Pavarësisht se kemi ofruar fakte dhe dëshmi të mjaftueshme, AK dhe komisioni i rivlerësimit nuk kanë marrë masa të duhura kundër OE për manipulim dhe falsifikim të specifikimeve. Arsyeja e tyre që nuk kanë ekspertë për këtë çështje dhe ky arsyetim është i papranueshëm, pasi është obligim i zyrtarit përgjegjës të prokurimit të dhe komisionit teknik të vlerësimit, duke pasur parasysh që anetarë të komisionit Teknik janë inzhinjer të kësaj natyre, që të analizojnë dhe vlerësojnë çdo ofertë në përputhje me kërkesat e tenderit dhe rregullat e prokurimit. Përgjigja e dhënë se “NUK KEMI EKSPERT” është jo profesionale dhe e papranueshme. Ky qëndrim krijon dyshime serioze dhe duket si një përpjekje me qëllime të këqija, vetëm për të mundësuar që ky OE të shpërblehet me kontratë, duke fshehur manipulimet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit. Kjo sjellje është në kundërshtim me parimet e transparencës dhe integritetit të procesit të prokurimit. Me vetë faktin që ju deklaroheni se “nuk jeni ekspert” për vlerësimin e dokumentacionit, atëherë në çfarë baze shpërblehet një OE që ka falsifikuar dokumentacionin e dosjes së tenderit (specifikimin teknik)? Si ka mundësi që ju keni arritur në përfundimin se ky OE ka plotësuar kërkesat për specifikimin teknik dhe është i përgjegjshëm, duke injoruar këto manipulime të qarta dhe të dëmshme? Përplasja mes komisioneve: Është shqetësuese dhe befasuese që komisioni i rivlerësimit ka konstatuar se OE ka paraqitur një specifikim të plotë dhe në përputhje me kërkesat në dosjen e tenderit, ndërkohë që

komisioni I pare i vlerësimit ka identifikuar se specifikimi i OE është i pasaktë dhe i jo i plotë dhe është i kopjuar nga specifikimi teknik në dosjen e tenderit. Përgjegjësia e zyrtarëve të prokurimit: Pavarësisht dy vendimeve të kundërta, është përgjegjësi e zyrtarit përgjegjës të prokurimit të analizojnë dhe shqyrtojnë me kujdes faktet dhe të bëjnë vlerësimin përfundimtar në përputhje me kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në përputhje me dispozitat dhe rregullat e LPP-së.

- Përfshirja e njësisë kërkuese në vlerësimin e ofertave: Është e diskutueshme dhe mund të krijojë një konflikt interesi kur njësi kërkuese është e përfshirë në vlerësimin e ofertave, veçanërisht kur ka mundësi të ndikojë në procesin e vendimmarrjes për shkak të lidhjeve të mundshme me OE.

1. Certifikata CE: • OE ka paraqitur një Certifikatë CE që nuk është për këmbyesin që ka ofruar në ofertën e tij, por për një model tjetër këmbyesi, të tipit "Brazed Plate Heat Exchanger". Ky fakt paraqet një kundërshtim me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe një mangësi e rëndësishme, pasi certifikata duhet të jetë për produktin e ofruar, konkretisht, Certifikata CE do të duhej të ishte për modelin e këmbyesit "SF 152" të cilin OE e ka ofruar.

2. Referencat : Referencat që ka paraqitur OE janë të dyshimta, pasi janë të lidhura me një kompani tjetër që është pjesë e grupit të prodhuesit, gjë që mund të nënkuptojë që ky OE mund të ketë përdorur referenca të paautorizuara ose të pasakta për produktin që ka ofruar.

3. Problemi me Çmimin e Ofertuar: OE ka ofruar një çmim jashtëzakonisht të ulët për produktin, dhe kjo ka ngritur dyshime se si është e mundur që ky çmim të jetë kaq i ulët, kur dihet se prodhimi i këmbyesve të nxehtësisë është një proces i shtrenjtë. Ky çmim mund të jetë një indikator për mundësinë e ofrimit të informacioneve të pasakta ose mashtruese, që mund të cenojnë cilësinë dhe besueshmërinë e produktit të ofruar.

4. Shkelja e Deklaratës Nën Betim dhe shkelja e nenit 59 të LPP-se: • OE ka paraqitur informacion të pasaktë dhe mashtruese në deklaratën nën betim, duke përdorur specifikime të falsifikuara dhe duke fshehur detaje të rëndësishme për produktin. Kjo është një shkelje e rëndë që mund të dëmtojë integritetin e procesit të tenderit dhe besueshmërinë e OE. Po ashtu, është bërë një shkelje e rëndë e Deklaratës nën Betim dhe e nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), nga komisioni i rivlerësimit, pasi ata nuk kanë marrë parasysh faktet dhe dëshmitë e paraqitura dhe kanë shpërblyer me kontratë një OE që ka ofruar informata të pasakta, mashtruese dhe të falsifikuara dhe vlerësimi, krahasimi dhe ekzaminimi i tendereve nuk është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-se e po ashtu ky vlerësim është bërë në kundërshtim me kërkesat e AK të pershtruara në dosjen e tenderit. Prandaj, konsiderojmë se vendimi i AK/i komisionit të rivlerësimit është një vendim jo profesional dhe tendencioz, i cili ka qëllime dhe prapavija të caktuara, për persona të caktuar që janë involvuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në këtë proces të rivlerësimit dhe duke favorizuar një OE i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit. Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e krijuara dhe pretendimet tona, për të cilat kemi ofruar fakte dhe dëshmi të mjaftueshme, si dhe faktet e dërguara nga ana e prodhuesit Alfa Laval me datë 19.12.2024, kërkojmë nga OSHP si organ kompetent që të APROVOJË ankesën tonë dhe lëndën ta kthejë për RIVLERËSIM, të ANULOJË VENDIMIN E AK për dhënien e kontratës një OE-je që nuk i ka plotësuar kushtet dhe kërkesat e AK-së dhe që ka paraqitur informata të pavërteta, mashtruese dhe të falsifikuara, dhe, duke pasur parasysh se ne i kemi plotësuar të gjitha kushtet dhe kërkesat e AK-së të parashtruara në dosjen e tenderit, dhe

jemi OE i përgjegjshëm që kemi ofruar minimumin më të ulët, të shpërblehemi me kontratë, ashtu siç është vendosur me vendimin e datës 31.10.2024.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi "BUSINESS PRO" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni, 1, 7, 10,11,59 i LPP-se Po ashtu, kërkojmë nga OSHP që të aplikohet neni 99.2 për OE që ka ofruar informata të gabueshme dhe përmbajtjesisht mashtruese dhe ka bërë shkelje të Deklaratës nën betim. Kërkojmë gjithashtu që ky nen të aplikohet edhe për komisionin e rivlerësimit për shkelje të Deklaratës nën betim, pasi, edhe pse ne i kemi dërguar të gjitha faktet dhe dëshmitë që vërtetojnë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, duke mos i plotësuar kushtet dhe kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit, komisioni i rivlerësimit, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit të sekondar, ka favorizuar një OE mashtrues dhe falsifikues dhe e ka shpërblyer me kontratë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për "BUSINESS PRO" SH.P.K.,

Departamenti i prokurimit ka pranuar kerkese per nshqyrtim nga O.E - BUSINESS PRO SHPK me daten:23.12.2024 ,pas pranimi te kerkeses per rishqyrtim kemi pezullar aktivitetin e prokurimit me daten: 24.12.2024. Zyrtari i prokurimit i është drejtuar departamentit të njësisë së kërkesës përmes emailit lidhur me kërkesën për rishqyrtim , të pranuar pasi qe pretendimet ankimore kane te bjene me pjesen tekmeke të këti aktiviteti të prokurimit ,dhe me datën 30.12.2024 kemi pranuar përgjigjeje nga zyrtan përgjegjes në departamentin e prodhimit/kogjenenmit ku konfirmohet përgjigjeja e marre në kohen e vlersimit të pare si në vijim:

Grupi i Operatoreve Ekonomik ka ofertuar se bashku me prodhuesin son flovv dhe autoriteti kontraktues ne vlersin e par ka kërkuar sqarim shtese nga GOE dhe kanë konfirmuar se i plotësojne gjitha kerkesat e autoritetit kontraktues gjith ashtu departamenti i prokurimit i ka derguar kerkesat per rishqyrtim prane departamentit te njesis se kerkeses dhe jane konstatuar se GOE i rekomanduar per kontrate i plotesone kerkesat e Autontetit kontraktues , Departamenti i prokurimit nuk ka ne perberje eksperte te kesaj fushe , perkatese dhe Oferta e rekomanduar per kontrate eshte oferta me cimm me te lire te Ofruar.

Nese nje pretenim i tille vertetohet nga ekspertet profesional ose organ pergjegjes se ka ndyshime te dokumenteve , autoriteti kontraktues do te veproje konforme neint 99 pika 2.

Autonteti kontraktues ka vepruar konofrme Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 1. Të gjitha autontetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe bunmet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Oferta e O.E - BUSINESS PRO SHPK nuk eshte oferta me cimm me te lire te ofruar ka nje difference prej 20,971.60 euro me oferten e rekomanduar Bashkangjitur gjeni emailin e pranuar nga njesia e kerkeses dhe pergjigjejen e GOE te rekomanduar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 23.01.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0027/2025 ndërsa me datë 23.01.2025 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0031/2025

Lidhur me ankesën nr. 2025/0027 me datë 02.03.2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2025/0027 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e Bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 2025/0031 me datë 02.03.2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me Nr. 2025/0031 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e Bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raportin e ekspertizës me nr.0027/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK ka dhënë përgjigje rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0031/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhënë përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës shqyrtuese, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “EJONA” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0027 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje për Pretendimin nr.1

Pretendimi ankues i OE ankues se janë shkelur neni 5; 5.5 dhe 5.8 i UDHËZUESIT Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK , qëndron, pasi që OE i shpallur fitues nga AK ka ofruar katalog nga prodhuesi SonFlow në të cilin katalog ka ndërhyrë me specifika teknike të një prodhuesi tjetër CETETHERM.Në lidhje me pretendimin ankues të OE ankues se është shkelur Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve) i LPP-së , qëndron pasi që AK shpërblen me kontratë OE i cili ka kryer ndërhyrje, modifikim të katalogut, ku ka kopjuar specifikimet teknike të detyrueshme në DT duke ia shtuar në fund vulën e një prodhuesi tjetër.

Gjithashtu në raportin e vlersimit të dt. 23.09.2024 komisioni i vlerësimit të njëjtin OE e ka shpallur si të pa përgjegjshëm pikërisht për këtë katalog. Pas kërkesave për Rishqyrtim AK e ka kthyer lëndën në Rivlerësim. Me dt. 12.12.2024 nga komisioni i Rivlerësimit është marrë vendim që i njëjti OE i cili herën e parë nuk i ka përmbushur specifikat teknike ashtu siq janë kërkuar

nga AK në DT, ky komision e ka shpallur fitues, edhe pse i janë kërkuar sqarimeve shtesë këtij OE (GOE ZILONIS Kosova: SonFlow Deutchalnd GMBH) nga AK, dhe i cili është munduar t'i arsyetoj këto specifika teknike, dëshmitë e dokumenteve të ofruara nuk e paraqesin si të përgjegjshëm.

Përgjigje për Pretendimin nr.2

Pretendimi ankimor i OE ankues se GO i shpallur fitues nga AK nuk kane ofruar deklarata të veçanta për themelimin e grupit, nuk qëndron pasiqe GO kanë ofruar një deklaratë mbi themelimin e grupit ku janë të cekura të gjitha përgjegjësit e përbashkëta dhe të veçanta të cilat i bartin këta OE, si themelues të këtij grupi.

Pretendimi ankimor i OE ankues se OE BAK ING i shpallur nga AK si i përgjegjshëm por me çmim më të lartë, qëndron pasiqe OE në fjalë të gjitha referencat e ofruara sipas listës së kontratave të kryera, janë të natyrës së furnizimit me material elektrik, e jo të natyrës se ngjajshme ashtu siq është kërkuar në DT dhe ne njoftimin për kontratë të AK.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BUSINESS PRO” SH.P.K., Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0031 ka vlerësuar se:

Përgjigje në Pretendimet ankimore

Pretendimi ankimor i OE ankues se AK nuk e ka bërë vlerësimin në përputhje me nenet 1,7 dhe 59 të LPP-së qëndron, për faktin se në ofertën e kompanisë së rekomanduar për kontratë e cila nuk e ka plotësuar Aneksin 1 të dosjes së tenderit Specifikimi teknik i detyrueshëm, respektivisht e ka kopjuar këtë specifikim teknik duke ia bashkangjitur katalogut të një prodhuesi krejt tjetër. Në katalogun origjinal i cili gjendet në web faqen e prodhuesit, dimensionet e këmbjesit dallojnë me ato të kërkuara në specifikat teknike të DT e të cilat dimensione mund të paraqesin problem në montimin dhe instalimin e tyre. OE i shpallur fitues nga AK për ta mbuluar këtë dallim ia ka bashkangjitur specifikat teknike të DT këtij katalogu.

Pretendimi ankimor i OE ankues se OE i shpallur fitues nga AK ka ofruar Çertifikatën e CE për një produkt tjetër e jo me ate me të cilin ka ofertuar sipas katalogut SF 152, qëndron pasiqe në DT dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar si kriter O.E për produktin e ofruar duhet te posedojë produkti Certifikatën Evropiane CE.

Pretendimi ankimor i OE ankues se OE i shpallur fitues nga AK e ka ofruar një referencë të dyshimtë, është pjesërisht i bazuar, sepse Referenca e ofruar është konfuze pasiqe është e lëshuar nga një kompani tjetër por që është pjesë e grupit të prodhuesit.

Sa i përket pretendimit ankimor te OE ankues se OE i shpallur fitues nga AK, se ka ofruar një çmim jashtëzakonisht të ulët dhe të dyshimt për këtë produkt, kjo mbetet në përgjegjësinë e AK.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim

të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e OE “EJONA” SH.P.K., me nr. 2025/0027, dhe OE “BUSINESS PRO” SH.P.K. me nr.2025/0031 të aprovohen si të bazuar.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me kembyes të nxehtësisë 11 MW” me nr. të prokurimit: NP Termoskos.sha-24-8946-1-2-1, të anulohet B58Njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim, dhe gjatë rivlerësimit AK të veprojnë sipas raportit të ekspertit shqyrtues si dhe në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II, III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A., Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A.**
- **OE - " EJONA " SH.P.K., BUSINESS PRO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: